

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI EKONOMIK

DEPARTAMENTI: BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET



**Analiza krahasuese e inflacionit dhe kredive joperformuese
në vendet e Ballkanit Perëndimor: Analizë rasti-Kosova**

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Qazim Tmava

Kandidati:

Armend Baliu

Mitrovicë, 2023

PUBLIC UNIVERSITY OF MITROVICA “ISA BOLETINI”
FACULTY OF ECONOMICS
DEPARTMENT: BANKING, FINANCE AND ACCOUNTING



Thesis: Comparative analysis of inflation and non-performing loans in the countries of the Western Balkans: Case study-Kosova.

Supervisor:

Prof. Asoc. Dr. Qazim Tmava

Candidate:

Armend Baliu

Mitrovica, 2023

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI EKONOMIK

DEPARTAMENTI: BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET



PUNIM DIPLOME

Lënda: Financa

Titulli i Punimit: **Analizë krahasuese e inflacionit dhe kredive joperformuese në vendet e Ballkanit Perëndimor: Analizë rasti-Kosova.**

Emri dhe Mbiemri: Armend Baliu

Statusi i Studentit: i rregullt

Numri i Amzës (ID Regjistri): 1605011065

Niveli i Studimeve: Bachelor

Departamenti: Banka, financa dhe kontabilitet

Programi i studimit: Banka, financa dhe kontabilitet

Mentori i punimit: Prof. Asoc. Dr. Qazim Tmava

Aprovuar prej komisionit:

1. Mentori

Emri/Mbiemri/Titulli:

2. Anëtar

Emri/Mbiemri/Titulli:

3. Anëtar

Emri/Mbiemri/Titulli:

FALËNDERIM

Ky punim i diplomës u realizua me shumë mund dhe shpresoj që kam dhënë kontribut të çmueshëm në këtë drejtim.

Falënderoj shumë mentorin e temës së diplomës Prof. Asoc. Dr. Qazim Tmava. Mbështetja dhe kurajo që më dha gjatë tërë kohës së pregaditjes së punimit të diplomës ishte për çdo respekt. Andaj, e falënderoj nga zemra!

Njëherit falënderoj komisionin e mbrojtjes së temës, për kontributin e dhënë në realizimin e këtij punimi të diplomës. Qofshi faqebardhë gjithmonë!

Mbi të gjitha, falënderoj Familjen time, veçanërisht prindërit e mi, që më mbështetën çdoherë në realizimin e synimeve dhe qëllimeve të mia jetësore. Mbështetja dhe përkrahja e tyre ishte e parezervë. Krenaria ime!

Deklarata e origjinalitetit/Autorësisë

Punimi im i diplomës është origjinal dhe kam respektuar autorësinë e çdo informacioni dhe burimi nga e kam marrë. Këtë punim/temë të diplomës e gjeni të shkruar vetëm nga unë, nga askush tjetër.

Ky punim është i publikuar vetëm nga unë. Deklaroj se gjatë punimit të tij kam respektuar të gjitha rregullat etike të punës akademike dhe shkencore të Univeristetit të Mitrovicës “Isa Boletini”.

Statement of originality/Authority

My thesis is original and I have respected the authorship of all information and sources from which I obtained it. You will find this thesis/diploma topic written only by me, no one else.

This topic is published only by me. I declare that during my work I have respected all the ethical rules of academic and scientific work of the University of Mitrovica “Isa Boletini”.

Data/Date: .2023

Armend Baliu

(nënshkrimi-signature)

ABSTRAKTI

Ky punim trajton temën e inflacionit, si dhe kredive joperformuese në vendet e Ballkanit Perëndimor, me fokus te veqante ne ekonomine e Kosoves, si vend ne tranzicion.

Ekonomia e Kosovës është një ekonomi e brishtë, e dalë nga lufta, ku shumcka filloi nga zeroja. Përkundër kësaj, sistemi bankar i themeluar nga fillimi, trajtohet si storie suksesi. Zhvillimi i këtij sektori, ndër vite tregon gjithmonë, ka treguar gjithmonë parametra në rritje. Në këtë drejtim edhe portfolio kreditore e bankave komerciale si dhe ndermjetësve financiar në përgjithësi, ka treguar performancë të mirë. Kreditë e joperformuese (si kredi të kqija, ato që trajtohen ne vonesë me tepër se 90 ditë) si pjesë e portfolios kreditore, janë tejet me rëndësi për shqyrtim, pasi që këto nuk sjellin kamatë dhe se banka duhet të ndajë rezerva të mëdha për këtë kategori.

Kreditë e tilla krahasuar me vendet e rajonit tek ne, janë më të ulta ndër vite, por gjithsesi duhet të trajtohen me kujdes.

Gjithashtu e dhe inflacioni si kategori makroekonomike, dhe shqyrtimi i tij dhe krahasimi me kredite joperformuese është me rëndësi të madhe për ekonominë e vendit.

Fjalë kyqe: kredi, kredi joperformuese, inflacioni, rritje ekonomike, Kosova.

ABSTRACT

This paper deals with the topic of inflation, as well as non-performing loans in the countries of the Western Balkans, with a special focus on the economy of Kosovo, as a country in transition.

The economy of Kosovo is a fragile economy, emerging from the war, where most of it started from scratch. Despite this, the banking system established from the beginning is treated as a success story. The development of this sector, over the years, always shows, has always shown increasing parameters. In this regard, the credit portfolio of commercial banks as well as financial intermediaries in general has shown good performance. Non-performing loans (such as bad loans, those that are overdue for more than 90 days) as part of the credit portfolio, are very important for consideration, since they do not bring interest and the bank must allocate large reserves for this category.

Compared to countries in the region, such loans are lower over the years, but they should be treated carefully.

Also, inflation as a macroeconomic category, and its examination and comparison with non-performing loans is of great importance for the country's economy.

Key words: loans, non-performing loans, inflation, economic growth, Kosova.

PËRMBAJTJA

Falënderim	4
Deklarata e originalitetit/Autorësisë	5
Abstrakti.....	6
Kapitulli I	
1.HYRJE	9
1.1 VESHTRIM I SHKURTER I INDIKATOREVE MAKROEKONOMIK NE KOSOVE....	12
1.1.1 Krijta ekonomike.....	13
1.1.2 Inflacioni.....	14
1.1.3 Inflacioni ne vendet e Ballkanit Perendimor.....	15
Kapitulli II	
2. SISTEMI BANKAR NË KOSOVE.....	16
2.1 BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS – BQK.....	17
2.1 Bankat komerciale.....	18
2.2.1 Struktura e aseteve në sektorin bankar.....	22
2.2.2 Struktura e detyrimeve në sektorin bankar.....	24
2.3 Portfolio kreditore dhe kredite joperformuese.....	26
2.3.1 Kredite joperformuese ne Kosove.....	29
2.3.2 Kredite joperformuese ne vendet e Ballkanit Perendimor.....	32
2.3.3 Provizionimi i kredive joperformuese në Kosovë.....	34
Kapitulli III	
3.KONKLuzionet dhe Rekomandimet.....	35

3.1 Konkluzionet	35
3.2 Rekomandimet.....	36
Literatura.....	37

Shkurtesat

ASK- Agjencia e Statisitkave e Kosovës

ATK - Administarta tatimore e Kosovës

BB - Banka Botërore

BE - Banka Ekonomike

BK- Banka komerciale

BKT - Banka Kombëtare Tregtare

BPB - Banka per Biznes

BQK– Banka Qendërore e Kosovës

EC- Komisioni europian

ECB- Banka Qendrore Europiane

FMN- Fondi Monetar Nderkomkbetar

P.P. - Pikë përqindje

RHZ-Banka Raiffhaizen

TEB - Turk Ekonomi Bankasi A.S.

TEB - Banka TEB

PcB - ProCredit Bank

NLB – Banka NLB

Kapitulli I

1. HYRJE

Ekonomia e Kosovës, perkundër faktit që filloi nga zeroja, pasi që lufta shkatërroi gati cdo gjë, kishte një rritje të knaqshme ndër vite. Mirëpo, një e rritje e tillë është me tepër si rezultat i një baze tejet të ultë, andaj rezulton një përqindje relativisht të knaqshme, se sa që është një rritje e mirëfilltë. Ekonomia e Kosovës përbën një ekonomi të re dhe dinamike. Baza e saj është transformuar nga një ekonomi centraliste, e dirigjuar, në një ekonomi të hapur të tregut. Qëllim në vete tashmë është rritja e konkurrencës së kësaj ekonomie, duke rritur kapacitetin e saj eksportues për të zvogëluar deficitin tregtar që Kosova aktualisht ka.¹

Si vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit, Kosova ofron edhe një sërë avantazhesh komparative siç janë: popullsia e re dhe mjaftë mirë e kualifikuar, resurset natyrore, kushtet e volitshme klimatike, infrastruktura e re, politika fiskale me taksat më të ulëta tatimore në rajon, pozita e volitshme gjeografike etj. Kosova që nga qershori i vitit 2009 është anëtarësuar edhe në Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, por dhe aspiron në mekanizma tjerë të fuqishëm ekonomik-financiar si Banka Europiane për Zhvillim dhe Rindertim, Organizata botërore etj.

Disa të dhëna statistikore me rëndësi të ekonomisë:

Nr. i banorëve: 1.8 milion

Sipërfaqja: 10,908 km²

GDP: 4.2 miliardë € (2010 v)

GDP shkalla e rritjes ekonomike: 4.0% (2010 v)

GDP për kokë banori: 1909 € (2010 v)

GDP - ndarja në sektorë: bujqësia 20%, industria 20%, shërbimet 60%

Shkalla e papunësisë rreth 25.0%

Shkalla e inflacionit: 19% (2022)

Resurset natyrore: linjiti, zinku, plumbi, ferro-nikeli dhe toka pjellore bujqësore.

Valuta: EURO

¹ <https://www.mei-ks.net/sq/kosova/ekonomia-e-kosoves#sthash.yjfS2Jo1.dpuf>

1.1 VESHTRIM I SHKURTER I INDIKATOREVE MAKROEKONOMIK NE KOSOVE

Ekonomia e Kosovës është një ekonomi në tranzicion.

Gjatë viteve 1990 heqja e institucioneve autonome si njesi e federates, e ndjekur nga politika të dobëta ekonomike, politika hegjemoniste, sanksionet ndërkombëtare, qasja e pakët në tregtinë dhe financat e jashtme, dhe konflikti etnik, dëmtuan rëndë ekonominë kosovare. Pas 1999, çdo gjë filloi nga zero. Filluan të themelohen institucionet. Në këtë drejtim edhe institucionet financiare, fillimisht Autoriteti Qendror i Bankave e Pagesave - AQBK (nëntor 1999), e më pas filluan edhe bankat komerciale. Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008 ekonomia e Kosovës është rritur çdo vit, edhe pse me efekte relativisht të ulëta nga kriza financiare globale, por që ende Kosova mbetet një nga zonat më të varfëra të Evropës, sipas raportit të Bankës Botërore.

Sistemi financiar i Kosovës ka vazhduar zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të tij në mënyrë të qëndrueshme.

Në tranzicionin e saj si një prej shteteve të fundit në Evropë, Kosova kaloi nëpër sfida të shumta ekonomike, që kanë të bëjnë me rindërtimin, ringjalljen, ndërtimin e institucioneve dhe krijimin e infrastrukturës themelore për ekonominë e tregut. Kosova është një ekonomi e vogël dhe e hapur ndaj tregut të jashtëm. Lokacioni gjeografik, investimet e vazhdueshme në infrastrukturë, mosha e re e popullsisë dhe pasuritë e saj natyrore përfaqësojnë karakteristikat themelore të ekonomisë së Kosovës.

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2013 shënoi normë pozitive të rritjes.

Sidoqoftë, aktiviteti i përgjithshëm ekonomik në vend u sfidua nga zhvillimet në tregjet rajonale dhe evropiane. Gjatë vitit 2013 kishte luhajtje të theksuar në disa nga burimet e rëndësishme të financimit në vend, veçanërisht investimet e huaja direkte dhe rritja e kredive dhe depozitave. Me zhvillime negative u karakterizuan edhe eksportet e mallrave, mirëpo rritja e eksporteve të shërbimeve neutralizoi efektin e gjithsej eksporteve.

Përveç kanaleve të sektorit të jashtëm të ekonomisë të cilët po ndikohen nga zhvillimet në ekonominë globale, ekonomia në vend vazhdoi të tregojë performancë solide marrë parasysh se sistemi financiar i vendit vazhdoi ndërmjetësimin financiar me normë pozitive të rritjes si në kuadër të kredive ashtu edhe në depozita.

Përkundër përkeqësimeve në disa sektorë të ekonomisë, sektori financiar e në veçanti sistemi bankar ka pasur performancë pozitive dhe vlerësohet të ketë përkrahur aktivitetin e përgjithshëm

ekonomik. Në anën tjetër, dërgesat e emigrantëve, si njëra ndër komponentët kryesore të financimit të konsumit në vend, vazhduan trendin pozitiv të rritjes madje më të theksuar se sa në katër vitet e fundit. Sektori publik gjithashtu vazhdon të ketë rol pozitiv në stabilitetin e ekonomisë së vendit si në kuadër të të hyrave ashtu edhe në kuadër të shpenzimeve buxhetore.

Përveç investimeve kapitale, sektori publik gjatë vitit 2013 nëpërmjet subvencioneve ka ndihmuar që të përshpejtohet ritmi i zhvillimit në sektorin e bujqësisë, pasi që është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të reja në këtë sektor.

Norma e inflacionit në Kosovë gjatë vitit 2012 ishte në vlerën prej 8.3% .

Sidoqoftë, sfidë e vazhdueshme në Kosovë mbetet norma e lartë e papunësisë, ndërsa norma aktuale e rritjes ekonomike nuk mjafton për të absorbuar rritjen e vazhdueshme të fuqisë punëtore në vend. Megjithatë, niveli relativisht i lartë i dërgesave të emigrantëve po kontribuon në zbutjen e kësaj barre për ekonominë e vendit.

1.1.1 Rritja ekonomike

Në tabelën me poshte do shihni normën e rritjes ekonomike në Kosovë, nëpër vite, si dhe normën e inflacionit nëpër vite.

Tabela nr.1 : *Norma e rritjes ekonomike dhe norma e Inflacionit në Kosovë, ndër vite*

Viti	Rritja ekonomike	Inflacioni
2008	5.4	9.4
2009	3.8	-2.4
2010	3.2	3.5
2011	4.5	7.3
2012	2.9	8.3
2013	2.4	1.7
2014	1.2	0.4
2015	4.1	-0.5
2016	4.1	0.3
2017	4.2	1.8
2018	4.0	2.8
2019	4.2	5.6
2020	4.0	5.8
2021	4.0	9.3

Burimi : *Banka Qendrore e Kosovës – Raporte Vjetore sipas viteve, kalkulim i autorit*

Siq verehet, rritja ekonomike tek ne ka shenuar rritje permanente, nder vite, mirepo duke pasur parasysh nivelin e zhvillimit ekonomik ne te cilin aktualisht eshte Kosova, nje rritje e tille nuk eshte e mjaftueshme.

1.1.2 Inflacioni

Inflacioni si kategori ekonjomike, paraqet rritjen e sasisë së ofertës së parasë në qarkullim në një ekonomi të caktuar brenda një periudhe të caktuar kohore. Një nga efektet që mund të shoqërohet me inflacionin është edhe rritja e çmimeve të të mirave material dhe shërbimeve. Andaj, kjo nënkupton zhvlerësimin i mjeteve kur me një sasi të caktuar të të hollave blihen më pak prodhime apo shërbime se sa përpara zhvlerësimit. Fenomeni i kundërt i saj është deflacioni. Për shkak të efekteve ekonomike gjithnjë e më të mëdha globale, si dhe për shkak se Kosova nuk ka njësi monetare të saj përmes së cilës do të mund të zbatonte politikat e saj monetare, nuk mund të bëj edhe aq shumë në uljen apo rritjen e këtij inflacioni, meqenëse paraja zyrtare e saj është euro dhe pak a shumë diktohen trendet e njëjta nga Evropa me ndryshime të vogla.² Inflacioni actual me teper eshte i importuar posaqerisht per shkak te luftes ne Ukraine, si dhe shkeputjes se zingjirit te furnizimit ne mbare boten.

Në vijim prezantojmë normën e inflacionit në Kosovë, sipas viteve:

Tabela nr. 2 Norma e inflacionit në Kosovë, sipas viteve:

vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
%	9.35	-2.41	3.48	7.34	2.48	1.77	0.43	-0.5	0.3	1.8	2.8	5.6	5.8	9.3

Burimi; SHBK- Periodiku bankar, maj, 2021

² SHBK-Periodiku bankar, maj, 2015

Nga tabela me sipër, mund të vërehet që ekonomia e Kosovës gjatë një periudhe prej 10 vitesh ka pasur një rritje ekonomike mesatare, prej 3.5%, ku viti 2007 karakterizohet me rritjen më të lartë prej 6.3%, ndërsa inflacioni më i lartë ishte në vitin 2008 në 9.4% .

Tabela nr. 3 *Inflacioni ne vendet e Ballkanit Perendimor, nder vite.*

Vendi/vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	3.36	2.28	3.55	3.45	2.03	1.94	1.63	1.91
B dhe H	7.42	- 0.39	2.19	3.68	2.05	-0.09	-0.93	-1.02
Kosova	9.35	- 2.41	3.48	7.34	2.48	1.76	0.43	-0.50
Maqedonia	8.33	- 0.74	1.51	3.90	3.32	2.78	-0.28	-0.30
Mali i Zi	8.76	3.47	0.65	3.45	4.15	2.21	-0.71	1.55
Serbia	12.41	8.12	6.14	11.14	7.33	7.69	2.08	1.39
Mesatare e vendeve te BP (2008-2015)	8.27	1.72	2.92	5.49	3.56	2.72	0.37	0.51

Burimi: *World Bank Group, kalkulimi autorit*

Nga me sipër, konstatojmë se inflacioni ne vendet e BP, per periudhen e analizuar 2008-2015, ne fillim te Krizes financiare globale, (2008) reflektonte nje norme relativisht te larte dhe sillej mes 3.36% ne Shqiperi dhe 12.41% ne Serbi. Mesatarja e normes se inflacionit ne kete vit, per te gjitha vendet ishte 8.27%. Perndryshe, neper vite, norma e inflacionit rezultonte e ulte dhe ne raste te caktuara pasohej me deflacion, siq ishte rasti tek Kosova me (2.41%), Maqedonia (0.74%) dhe BeH (0.39%). Nje trend i tille i normes se ulte te inflacionit percillet deri ne vitin 2015, ku mesatarja e normes se inflacionit ishte vetem 0.51%. Perndryshe, per tere periudhen, norme me te larte inflatore rezulton te jete ne Serbi prej 7.04%, Mal te Zi prej 2.94%, Shqiperi prej 2.52%, Kosove prej 2.74%, dhe Maqedoni prej 2.32%. Norma me e ulte e inflacionit pasqyrohet ne BeH vetem me 1.61% per tere periudhen, qe ne fakt eshte per 1.48% nen mesataren inflatore te vendeve te regjionit.

Kapitulli II

2. SISTEMIBANKAR NË KOSOVË

Sistemi bankar është shtylla kryesore e e sistemit financiar, i cili në Kosovë përbëhet nga: Bankat Komerciale, Kompani të Sigurimeve, Fonde të Pensioneve, Institucione Mikrofinanciare, Asociacione Kreditore dhe Institucione Financiare jo bankare, të licencuara dhe të mbikqyrura nga BQK.³

Dmth perkunder faktit se sistemi financiar eshte i ri, perbehet nga nje lepeze e gjere e institucioneve financiare dhe bankare.

Në mënyrë skematike, në vijim, e prezantojmë numrin e institucioneve financiare, sipas viteve:

Tabela nr. 4: *Numri i institucioneve financiare ne Kosove (2012-2021)*

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Bankat komerciale	8	9	10	10	10	10	10	10	10	11
Kompanitë e sigurimeve	13	13	13	15	15	15	15	15	15	15
Fondet pensionale	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	39	40	41	43	43	43	43	43	43	43
Institucionet mikrofinanciare	19	18	18	18	18	18	20	20	18	18

Burimi: *BQK, Buletini i sektorit financiar, Prishtinë, nderv vite.*

Siq verehet Bankat komerciale perbejne shtyllen kryesore te tere sistemit financiar. Sistemi bankar i Kosovës, është një sistem i ri, i themeluar pas vitit 1999 dhe përbëhet nga të dy nivele:

Niveli i parë: Banka Qendrore dhe

Niveli i dytë: Bankat komerciale (aktualisht dhjete sosh)

³ BQK, Raporti Vjetor www.bqk-kos.org

-Niveli i parë përfaqësohet nga Banka Qendrore si autoriteti monetar që harton dhe zbaton politikën monetare dhe nëpërmjet të cilës ndikon mbi aktivitetin ekonomik dhe

Niveli i dytë nga bankat komerciale që realizojnë pjesën kryesore të financimit të ekonomisë.

2.1 BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS – BQK

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është një entitet juridik publik me kompetencë të plotë bazuar në Kushtetutën dhe në ligjin përkatës. BQK-ja është institucioni kyç pjesëmarrës dhe rregullator në sistemin financiar të Republikës së Kosovës dhe ka autonominë administrative, financiare dhe menaxheriale.

Qëllimi kryesor i BQK-së është të promovojë dhe të mbajë një sistem financiar të qëndrueshëm, duke përfshirë një sistem pagesash të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas. Objektivi shtesë i BQK-së, i cili i nënshtrohet objektivit të saj kryesor është të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve të brendshme. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është një institucion publik i pavarur dhe objektivi i saj kryesor është të promovojë dhe të mbajë një sistem financiar të shëndoshë si dhe një sistem efikas të pagesave. Më 27 korrik 2010, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin nr. 03 / L-209 për "Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës". Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt juridik publik i bazuar në nenet 11 dhe 140 të Kushtetutës dhe dispozitave të këtij ligji, i cili ka të drejta administrative, financiare dhe menaxheriale autonomi.

BQK-ja dhe anëtarët e saj të organit vendimmarrës janë të pavarur dhe nuk janë të kufizuar nga instruksionet e Qeverisë apo të çfarëdo autoriteti tjetër në kryerjen e detyrave të caktuara ligjore, si dhe nuk mund të kërkojnë drejtime apo udhëzime nga ata. BQK-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen e monedhës Euro e cila përdoret si valutë zyrtare në Republikën e Kosovës. BQK-ja menaxhon dhe mbikëqyrë kartëmonedhat dhe monedhat në përputhje me përvojat dhe standardet më të mira. BQK-ja mirëmban pavarësinë e saj financiare përmes fitimit të qëndrueshëm duke kontrolluar efikasitetin e kostos së aktiviteteve dhe operacioneve të saj.

Për shkak se BQK-ja nuk gjeneron të hyra përmes operacioneve monetare, të ardhurat e saj determinohen nga tregu. BQK-ja cakton tarifatat dhe detyrimet e pagesave për provizionin e

shërbimeve të saj në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira. Objektivi primar i BQK-së është të mbrojë vlerën e aseteve financiare si dhe të ruaj kapacitetin e saj në mënyrë që së bashku me Thesarin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të mbështesë likuiditetin e sektorit financiar.⁴

2.2 BANKAT KOMERCIALE NË KOSOVË

Në Kosovë aktualisht operojnë 11 (njembedhjetë) banka komerciale, të cilat, përbëjnë rreth 70 përqind të aseteve totale të sektorit financiar, ndër vite dmth përbejn e pjesen qendrore te sistemit financiar.

Sipas SHBK, ktiviteti i tyre dominohet nga kreditë, afati i maturimit i të cilave mund të jetë deri në 20 vjet, varësisht nga lloji i kredisë. Nga totali i kredive i cili është 3,931 milion euro, kreditë për ndërmarrjet janë 62.5% ndërsa kreditë për individë/familjare 37.1%. Pjesa më e madhe e këtyre kredive absorbohet nga ndërmarrjet e sektorit të tregtisë (43.4% përqind e kredive të ndërmarrjeve), përderisa sektori i industrisë (përfshirë minierat, prodhimtarinë, energjinë dhe ndërtimtarinë) ka 35.8% të gjithsej kredive të ndërmarrjeve. Sektori i bujqësisë aktualisht përbën 2.1% të gjithsej kredive për ndërmarrje. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat përfaqësojnë 81.5% përqind të gjithsej detyrimeve. Depozitat e sektorit bankar kanë shënuar rritje vjetore prej 7.3% duke arritur vlerën prej 4,746 miliarde euro. Depozitat e sektorit bankar në Kosovë përbëhen nga depozitat e ekonomive familjare me një pjesëmarrje prej rreth 70.5% përqind të depozitave të gjithmbarshme, përderisa depozitat e ndërmarrjeve private përbëjnë 23.1% përqind ⁵.

Bankat komerciale në Kosovë kanë strukturë të ndryshme aksionare. Nëntë prej tyre janë banka me kapital të huaj dhe dy me kapital vendor.

Numri i të punësuarve aktualisht në bankat komerciale është rreth 3,583.

⁴ BQK, www.bqk-kos.org

⁵ SHBK, 2021

-Bankat komerciale, të cilat operojnë në Kosovë janë:

1. *Banka Për Biznes*
2. *Banka Ekonomike*
3. *Raiffeisen Bank Kosovo*
4. *Procredit Bank*
5. *TEB*
6. *NLB Prishtina*
7. *Banka Kombëtare Tregtare*
8. *Türkiye İş Bankası*
9. *Komercijalna Banka*
10. *ZIRAAT Bankasi.*
11. *Credins Bank*

Që të gjitha operojnë nën mbikqyrjen e BQK-se, si autoritet rregullues.

Bankat komerciale kryejnë veprimtaritë e tyre në mënyrë të pavarur, duke u bazuar në ligjet e aplikuara të cilat e rregullojnë sektorin bankar. Bankat me pronësi të huaj, vazhdojnë të dominojnë në sektorin bankar të Kosovës, ku nga gjithsej njembdhjetetë banka të licencuara të operojnë në vend, nëntë janë me pronësi të huaj dhe menaxhojnë mbi 90.4 përqind të gjithsej asetëve dhe zotërojnë 93.0 përqind të gjithsej kapitalit të sektorit bankar⁶. Shikuar sipas vendit të origjinës së bankave, Austria, Gjermania, Sllovenia, Shqipëria dhe Serbia përfaqësohen me nga një bankë të vetme, përderisa Turqia përfaqësohet nga tri banka.

Aktualisht bankave komerciale që veprojnë në Kosovë janë këto, Banka Kreditore e Prishtinës, NLB Banka, Banka për Biznes, Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi, Banka Ekonomike, Raiffeisen Bank Kosovo, Procredit Bank, TEB Banka, Banka Kombëtare Tregtare, Turkiye is

⁶ SHBK, www.bankassoc-kos.com

Bankasi, Komercijalna Banka ad Beograd - dega Mitrovicë si dhe Credins bank.⁷ Aktualisht kater banka të mëdha (Pro Credit Banka, Raiffaissen Bank, TEB banka, si dhe NLB Banka), paraqesin Katershen e madhe të sistemit bakar në Kosovë, asetet e tyre përfshijnë mbi 75 % të tërë sistemit bankar. Ne vijim prezantojme pjesmarrjen e sektorit bankar dhe ndërmjetësve të tjerë në sektorin financiar në Kosovë, ndër vite:

Tabela nr. 5 : *Pjesmarrja e sektorit bankar dhe ndërmjetësve të tjerë në sektorin financiar në Kosovë, ndër vite*

Viti	Sektori Bankar	Ndërmjetësit tjerë	Sistemi financiar
2006	88.9	11.1	100.0
2007	87.9	12.1	100.0
2008	80.1	19.9	100.0
2009	78.6	21.4	100.0
2010	76.9	23.1	100.0
2011	76.1	23.9	100.0
2012	73.9	26.1	100.0
2013	72.3	27.7	100.0
2014	70.1	29.9	100.0
2015	69	31	100.0
2016	68.9	31.1	100.0
2017	67.3	22.7	100.0
2018	65.2	24.8	100.0

Burimi: *Raportet Vjetore të Bankës Qendrore të Kosovës (2006-2018)*

⁷ BQK, www.bqk-kos.org

Veprimtaria e bankave komerciale me tërë rrjetin e zhvillimit të tyre, me degët dhe nëndegët e saj, për periudhën 2008-2021, si dhe numrin e të punësuarëve e paraqesim në tabelën në vijim.

Tabela nr. 6 Numri i bankave komerciale me njesite si dhe numri i të punësuarëve

Vitet	Nr. i bankave	Degët	Nëndegët	Nr. i të punësuarëve
2008	8	46	233	3607
2009	8	49	238	3459
2010	8	49	254	3610
2011	8	43	259	3728
2012	9	43	258	3727
2013	9	44	245	3549
2014	9	45	223	3507
2015	10	45	210	3375
2021	11	43	204	3245

Burimi: BQK - Raportet vjetore, nder vite.

Në të dhënat e mësipërme, shohim se veprimtaria e bankave komerciale në Kosovë duke përfshirë numrin e degëve dhe nëndegëve, në vitin 2015, ka gjithsej dhjetë bankave komerciale, gjithsej 45 degë dhe 210 nëndegë. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe nëndegëve të bankave mbulon tërë territorin e vendit. Përqëndrim më i madh i degëve dhe nëndegëve bankare është në regjionin e Prishtinës (35%), ku edhe përqëndrimi i popullsisë është më i madh (25%).⁸ Ndërsa, numri i të punësuarëve në banka shënon 3,375 punonjës. Ne vitin 2021 nr. i bankave eshte njembedhjetë sosh.

⁸ BQK, 2016

2.2.1 Struktura e asetëve në sektorin bankar

Asetet në industrinë bankare tregojnë rritje permanente prej viti në vit dhe dominohen nga kreditë bruto, të cilat në terma relativ, përbëjnë mbi 60% të tërë industrisë. Paratë e gatshme dhe bilanci me BPK, përbëjnë rreth 15% nëpër vite, ndërsa bilanci me bankat, përbenë mesatarisht 10%. Kreditë bruto sillen mes 62.3% në vitin 2012, dhe 59.0 në vitin 2013. Në vitin 2016 mbulonin asetet me 61.3%

Kjo vërehet edhe nga tabela në vijim:

Tabela nr. 7 *Struktura e asetëve të sektorit bankar, sipas viteve*

Përshkrimet	2012		2013		2014		2015		2016	
	Mil.EUR	%	Mil. EUR	%	Mil. EUR	%	Mil.EUR	%	Mil. EUR	%
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	425.7	15.0	463.3	15.1	447.1	14.0	491.2	14.5	457.3	12.6
Bilanci me bankat komerciale	269.7	10.2	339.9	11.1	390.7	12.3	316.0	9.3	342.0	9.4
Letrat me vlerë	256.7	9.1	354.5	11.6	383.8	12.0	473.5	14.0	510.3	14.0
Kreditë bruto	1,763.4	62.3	1,805.8	59.0	1,882.4	59.1	2,019.4	59.6	2,230.0	61.3
Asete Fikse	57.7	2.0	55.5	1.8	53.7	1.8	57.3	1.7	58.5	1.6
Asetet tjera	38.1	1.3	40.3	1.3	27.9	1.3	29.8	0.9	38.7	1.1
Gjithsej	2,829.3	100	3,059.3	100	3,185.6	100	3,387.3	100	3,536.8	100

Burimi: BQK (2012=2017)

Sipas të dhënve të BQK, Sektori bankar i Kosovës vazhdoi të rritet në mënyrë permanente edhe gjatë kohës së krizës ekonomike botërore. Vlera e aseteve të menaxhuara nga bankat komerciale në fund të vitit 2009 arriti në 2.2 miliardë euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 21.9 përqind.

Pasi që kreditë zënë pjesën më të madhe të aseteve të sektorit bankar në Kosovë, do t'i hedhim një vështrim analitik rreth ecurisë katër vjeçare.

Kreditë vazhduan të karakterizohen me rritje të përshpejtuar që nga vitet paraprake. Në vitin 2015, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.02 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 7.3 përqind. Në kuadër të gjithsej kredive, kreditë ndaj ekonomive familjare në vitin 2015 shënuan rritje prej 9.7 përqind. Rritja e kreditimit të ekonomive familjare i atribuohet rritjes prej 27.7 përqind të kredive të reja hipotekare dhe rritjes prej 55.8 përqind të kredive të reja me kushte favorizuese, krahas rënies prej 2.8 përqind të kredive të reja konsumuese. Kontributin kryesor në rritjen e përshpejtuar të gjithsej kreditimit të sektorit e kanë dhënë kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat edhe kanë peshën kryesore në kuadër të gjithsej kredive (65.9 përqind të gjithsej kredive). Këto kredi shënuan rritje vjetore prej 6.1 përqind në vitin 2015. Rritja e kreditimit gjatë vitit 2015 i atribuohet lehtësimit kushteve të kreditimit nga ana e bankave, të realizuar përmes uljes së normave të interesit, zgjerimit të shumës së kredisë si dhe afatit të maturimit në kreditë e ofruara, si dhe rritjes së kërkesës për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Rritja e kërkesës për kredi në masë të konsiderueshme është nxitur nga rënia e normave të interesit në kredi gjatë këtij viti.

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike mbetet e kryesuar nga kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë (me pjesëmarrje prej 51.2 përqind), pasuar nga ato për sektorin e prodhimit (12.3 përqind) dhe sektorin e ndërtimit (7.5 përqind). Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë pjesëmarrje më të ulët në financimin bankar me pjesëmarrje prej 4.5 përqind, por gjatë kësaj periudhe është karakterizuar me rritje të përshpejtuar.⁹

Lëvizjen e strukturës së aseteve të sektorit bankar, nga viti 2012-2016 e kemi të specifikuar sipas zërave bilancor, në tabelën e mesipërme ku në mënyrë permanente kredite bruto sillen rreth 60%

⁹ Spahiu-Gjiko, 2017

ne baza vjetore. Kredite bruto, rriten ne menyre permanente krahas rritjes se aseteve dhe nga 1,763 mld eur ne vitin 2012, arrijne ne 2,230 mld eur ne vitin 2016.

Biles, rritja e aseteve percillet edhe ne vitet ne vijim, edhe ne vitin 2019 dhe 2020, edhe gjate kohes se pandemise COVID-19si dhe ne vitinn 2021.

2.2.2 Struktura e detyrimeve në sektorin bankar

Struktura e detyrimeve të industrisë bankare të Kosovës dominohet nga depozitat, që paraqesin burimin kryesor të financimit për bankat komerciale. Bazuar në të dhënat statistikore të BQK-së prej vitit 2010 deri 2016 vërehet se shkalla e depozitave ka shënuar rritje të kënaqshme në gjithë periudhën e sipërpërmendur. Në terma relativ, sillet mes 78.3%, në vitin 2011 dhe 79.5%, në vitin 2012.

Në qershor 2014, vlera e gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës arriti në 2.42 miliardë euro, rritje vjetore prej 10 për qind, që është dukshëm më e lartë krahasuar me dy vitet paraprake. Në qershor 2014, depozitat përfaqësuan 79.1për qind të gjithsej detyrimeve të industrisë bankare.

Me rastin e analizave të hollësishme që kanë të bëjnë me detyrimet e industrisë bankare, mund të vërehet se 79.8% (ne vitin 2015), perkatesisht 79.2% (ne vitin 2016) përbëhet nga depozitat, gjë që do të thotë se bankat gëzojnë një besim të madh tek popullata e Kosovës.

Kjo mund të verehet shume qarte edhe nga tabela vijuese.

Tabela nr. 8 : Struktura e detyrimeve të industrisë bankare -në përqindje (2010-2015)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Bilanci nga bankat tjera	2.9%	1.5%	0.2%	0.5%	1.0%	1.3%
Depozitat	78.9%	79.4%	80.6%	80.1%	79.6%	79.8%
Huatë tjera	1.0%	1.2%	0.7%	0.4%	0.4%	0.5%
Provizionet e shlyera	0.0%	0.0%	0.1%	0.1%	0.2%	0.1%
Detyrimet tjera	6.5%	7.2%	7.8%	8.0%	7.2%	5.6%
Borxhi i ndërvarur	1.3%	1.2%	1.1%	1.8%	1.5%	1.1%
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.0%	0.0%	-	-
Mjetet vetanake	9.4%	9.5%	9.5%	9.1%	10.1%	11.6%
Gjithesëj Detyrimet	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Burimi : www.bqk-kos.org

Siq vërehet nga tabela e mesipërme, pjesmarrja më e madhe në strukturën e detyrimeve në industrinë bankare është e depozitëve, të cilët në fund të vitit 2014, arrinte vlerën afër 80 %. Ndërsa, sipas afatit të maturimit, struktura e depozitave vazhdoi të dominohet nga depozitat e afatizuara (41.6për qind të gjithsej depozitave), pasuar nga depozitat e transferueshme (39.6për qind) dhe depozitat në formë të kursimeve (18.9për qind). Zvogëlimi i depozitave të afatizuara ka ndodhur për shkak të rënies së normës së interesit në depozita gjatë fillimit të vitit 2014.¹⁰

Kjo është e rëndësishë së veçantë, posaqërisht për Kosovën për arsye se historia jo fort e largët i ka sjellë përvoja jo të mira, bankave të Kosovës në lidhje me depozitat e klientëve.

¹⁰ BQK, 2016


Përkundër përvojës shumë të hidhur nga sistemi paraprak juridik, ku pjesës dërmuese të popullatës dhe ndërmarrjeve në mënyrë administrative u janë konfiskuar depozitët, prap se prap, potenciali depozitar, si faktor kyq i rritjes së ofertës kreditore të bankave komerciale në Kosovë, është përcjellur me një rritje permanente. Vlerësohet në mënyrë të dhunshme, Në periudhën 1990-1999, kursimtareve kosovare u janë grabitur mbi 116 milion DEM.

2.3 Portfolio kreditore dhe kredite joperformuese

Sektori i kredive është sektori ku gjenerohen më së shumti të hyra për bankën. Mirepo, është sektori ku rreziku është tejet i madh. Kështu, kredidhenja ka shënuar rritje të vazhdueshme ndër vite, në mënyrë permanente.

Sa i përketë ngritjes së vazhdueshme të kredidhënjes nga bankat, kjo vërehet edhe nga tabela e mëposhtme, ku pasqyrohet trendi i kredimit që nga viti 2010 deri në vitin 2016. Ka arsye që të bëhet edhe më shumë presion tek politikat kredituese të bankave në Kosovë, duke pasur si synim zbritjen edhe më të madhe të interesave, sidomos për ato banka të cilat siç u përmend edhe më herët, ka raste kur ballafaqohen me mbilikuiditet.

Figura nr. 1 *Struktura e kredive sipas sektorëve ekonomik, 2000-2018*



Burimi: BQK, në bazë të Raportëve vjetore, sipas viteve,

Kredite me probleme – kredite joperformuese, perkufizohen si kredi të cilat nuk sigurojnë më të ardhura dhe ate:

- a. pagesa e plotë e principalit dhe e interesit nuk është paguar,
- b. pagesa e tyre është 90 ose më shumë ditë me vonesë,
- c. data e maturimit ka kaluar dhe pagesa nuk ka përfunduar.

Nga ky perkufizim kredia konsiderohet me probleme kur personi ose subjekti i cili e ka marrë atë në banke bëhet një problem për shlyerjen e saj. Në fillim ka vonesa me dite, të cilat kalojnë në vonesa me javë e pastaj me muaj. Në raste të tilla bankat janë të detyruara të dergojnë njoftime klienteve për të informuar në lidhje me detyrimet shumë herë. Gjithashtu bankat vënë "gjoba" të cilat i shtohen shumës mujore që huamarresit duhet të paguajnë në bazë të përqindjes së caktuar të penalitetit në kontratën e kredise.

Sipas standardeve ndërkombëtare mbi menaxhimin e kredive, **Basel II**, një kredi konsiderohet me probleme kur pagesat e interesit dhe principalit kanë vonesë prej 90 ditësh apo më shumë.

-Sipas BQK, kreditë klasifikohen në:

1. *kredi standarte;*
2. *kredi vrojtuese;*
3. *kredi nenstandarte;*
4. *kredi të dyshimta;*
5. *kredi të humbura;*

Kredi standarte quhen kreditë e rregullta, dhe që nuk kanë asnjë problematike në afatin dhe shumën e shlyerjes.

Kredi vrojtuese quhen kreditë që paraqesin shenjat e para të vonesave në shlyerje dhe janë nën mbikqyrje nga ana e bankes, por që nuk janë klasifikuar ende si kredi problematike.

Kredi nenstandarte quhen kreditë të cilat nuk klasifikohen si kredi standarte, për shkak të vonesave në shlyerjen e tyre dhe *klasifikohen si kredi problematike.*

Kredi të dyshimta quhen kreditë të cilat kanë vonesa të theksuara në shlyerjen e tyre, por banka ka akoma shpresa në mbledhjen e tyre dhe ato *klasifikohen si kredi problematike.*

Kredi të humbura quhen kreditë të cilat nuk mund të mbledhen më nga ana e bankes dhe *klasifikohen si kredi problematike.*

Nga sa u theksua më lart, kredite me probleme klasifikohen në 3 kategori:

1. Kredi nënstandarde,
2. Kredi të dyshimta,
3. Kredi të humbura.

Kreditë me probleme- joperformuese (KJP-NPL) ndikojnë negativisht në performancën dhe stabilitetin e industrisë bankare, duke rritur provizionimin, tkurrë kreditimin dhe në raste më të rënda mund të sjellë një institucion financiar në gjendje insolvente. Gjatë procesit të kreditimit, industria bankare ballafaqohet me rrezikshmëri të ndryshme, përfshirë këtu: rrezikun kreditor, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e tregut, rrezikun operacional, rrezikun e reputacionit dhe rrezikun ligjor. Prandaj kemi të bëjmë me një industri shumë të ndjeshme ndikimi i së cilës mund të ketë pasoja të mëdha ekonomike në vend. Në këtë drejtim për këtë industri duhet të ketë mbikqyrje të veçantë nga rregullatori që në rastin e Kosovës është Banka Qendrore e cila e mbikqyrë këtë industri përmes legjislacionit ekzistues në fuqi, por edhe përmes rregulloreve që aprovohen për këtë industri. Bankat komerciale në Kosovë me qëllim të mbrojtjes nga kreditë joperformuese, ndërmarrin hapa parandaluese në mënyrë që pasojat të jenë sa më të vogla dhe këto të mos kenë ndikim të madh në performancën e tyre. Rezervat e detyrueshme, ku çdo bankë është e detyruar të deponoj në Bankën Qendrore të Kosovës, paraqesin hapin e parë në mbrojtje të rrezikut dhe i cili përdoret vetëm në rastet kur bankat nuk janë në gjendje që të mbulojnë obligimet e tyre. Provizionimi i kredive është një masë tjetër, ku bankat për çdo kredi të lëshuar paguajnë provizion në BQK.¹¹

Përveq kësaj bankat janë të obliguara që të mirëmbajnë gjithashtu edhe nivelet e likuiditetit për të qenë në gjendje të paguajnë në çdo kohë obligimet që i kanë ndaj klientëve. Përveç masave ligjore të cilat janë obligative për bankat komerciale, gjatë procesit të kreditimit për të siguruar kthimin e kredisë kërkojnë që klienti të lejoj si peng për bankën pasuri të patundshme apo kolateral në emër të asaj kredie dhe në rast të moskthimit, banka mund ta përvetësoj atë pasuri deri në masën e dëmit që i shkaktohet bankës nga mos kthimi i asaj kredie.

¹¹ Shoqata e Bankave të Kosovës, Korrik 2014

2.3.1 Kreditë joperformuese në Kosovë

Në Kosovë kreditë joperformuese kanë shënuar rritje të lehtë nga viti në vit, përderisa në fund të vitit 2013 vlera arriti në 8.5% në raport me bruto totalin e kredive të lëshuara nga industria bankare. Në fund të muajit mars 2014, kreditë joperformuese shënuan vlerën prej 8.4%. Në figurën nr.7 vërehet se rritja e normës së kredive joperformues është zvogëluar në 18.1% në vitin e fundit në krahasim me vitin paraparak kur kjo rritje ishte 35.8%.

-Tabela në vijim përmban informacion mbi treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit, raportin e kredive jo-performuese ndaj totalit të kredive të lejuara, si edhe fondet rezervë (provizionet) për sektorin bankar në Kosovë gjatë periudhës 2010-2016.

Tabela nr. 9 Treguesite e mjaftueshmërisë së kapitalit, kredite jo-performuese dhe provizionimi i tyre, nder vite.

Viti	Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit	Totali i Mjeteve/Kapitali Aksionar (herë)	Raporti i kredive jo-performuese ndaj totalit të huave	Provizione ndaj KJP-ve (%)
2010	18.7	10.6	5.9	114.0
2011	17.5	10.4	5.8	117.0
2012	14.2	10.4	7.5	112.6
2013	16.7	11.0	8.7	110.6
2014	17.8	9.9	8.3	114.4
2015	19.0	8.6	6.2	115.1
2016	17.9	8.6	4.9	126.5

Burimi: Raporte te BQK (2010-2016)

Nëse i tabelës se mesiperme konstatojmë se treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka qenë gjithmonë disa pikë përqindjeje më i lartë se treguesi minimal i përcaktuar nga BQK-ja (12%) dhe më i lartë se niveli minimal i kërkuar nga Marrëveshja Bazeli III (10.5%). Kjo nënkupton se sektori bankar në Kosovë është i mirëkapitalizuar, pra siguria e tij është në nivel të kënaqshëm. Natyrisht niveli relativisht i lartë i kapitalit ka ardhur edhe me koston e një shumëzuesi kapitali relativisht në ulje. Kështu shumëzuesi i kapitalit (i përafërt me levën financiare) nga rreth 10.6 në vitin 2010

është ulur në nivelin 8.6 në vitin 2016. Viti 2016, karakterizohet me rënie të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Niveli i kredive joperformuese shënoi rënie në 4.9 përqind, një nivel i ulët edhe krahasuar me vendet në Ballkanin Perëndimor . Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së stokut të kredive joperformuese me provizione, shënoi rritje në 126.5%. Pozita e likuiditetit të sektorit bankar vazhdon të jetë në nivel të qëndrueshëm, përkundër rritjes së përsheptuar të kreditimit.

Në anën tjetër do të duhej që të punohet më shumë në drejtimin e azhuritit të gjykatave në mënyrë që të mos iu lejohej institucioneve financiare që nën presionin e situatës së palakmueshme më gjyqësinë, në drejtim të zgjidhjes së kontesteve gjyqësore, rritet risku që ngërthen në vehte edhe mbajtjen e shkallës së intereseve në nivelin e tanishëm e ndonjëherë edhe ngritjen e tyre – mvarësisht nga kërkesat e parashtruara nga ana e klientëve-bizneseve.

Në të vërtetë këtu pasqyrohet shkalla e kredive të ashtuquajtura jo-performuese që është ndër më të ulëtat në regjion dhe ndër më të ulëtat në krahasim me vendet e EJK-ës .

Ne vijim paraqesim KJP nder sektore, ne Kosove, nder vite.

Tabela nr. 10 KJP sipas sektorëve

	Agrokulturë	Miniera	Prodhimtari	Energji	Shërbime & Turizëm	Komunikim	Tregti	Patundshmëri	Ekonomi familjare	Të tjerat
2014	3.00%	2.00%	14.10%	11.00%	11.00%	4.10%	10.70%	11.80%	2.40%	4.00%
2015	8.00%		15.70%	14.00%	11.70%	2.70%	10.30%	12.30%	2.50%	5.60%
2016	9.70%		12.20%	14.40%	9.20%	3.40%	11.50%	11.90%	2.80%	6.00%

Burimi: (BQK, Raporti Vjetor, 2014-2016)

Nga tabela e mësipërme konstatohet se KJP-të në sektorin e bujqësisë kanë pësuar rritjen më të madhe nga 3% (2014) në 9.7% (2016). Ndërsa sektori i energjisë prinë me KJP me 14.4% (2016). Të dhënat e mësipërme janë prezantuar edhe në figurën në vijim:




Figura nr. 2 KJP sipas sektorëve

Ky nivel është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat rregullatore, por prapëseprapë ka hapësirë për përmirësim të mëtejshëm dhe përafrim drejt mesatares rajonale.

Niveli i kredive joperformuese në Kosovë është afërsisht me mesataren e vendeve të Europës. Në vijim do të prezantojmë kredite joperformuese në Kosovë, ndër vite, të shprehura në mënyrë relative.

2.3.2 Kredite joperformuese në vendet e Ballkanit Perëndimor

Në vijim prezantojmë nivelin e kredive joperformuese në raport me totalin e kredive në Kosovë, si dhe shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor:

Tabela nr. 11 Kredite joperformuese ne raport me gjithsej kredite ne Kosove dhe Vendet e Ballkanit Perendimor, nder vite.

Kreditë jo-performuese në raport me gjithsej kredite (2010-2015)						
Shteti	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	14.0%	18.8%	22.5%	23.5%	22.8%	20.9%
Bosnja dhe Hercegovina	11.4%	11.8%	13.5%	15.31%	14.0%	14.1%
Kroacia	11.1%	12.3%	13.8%	15.4%	16.7%	17.1%
Kosova	5.8%	5.7%	7.4%	8.5%	8.3%	7.1%
Maqedonia	9.0%	9.5%	10.1%	10.9%	10.8%	11.0%
Mali i Zi	21.0%	15.5%	17.6%	18.4%	16.8%	16.7%
Serbia	16.9%	20.0%	18.6%	21.4%	21.5%	22.8%


Burimi: Raportet e Bankes Boterore, si dhe Raportet e BQ-ve, te vendeve respektive

Siq shihet nga tabela, Kosova prezanton perqindjen me te ulet te kredive joperformuese ne krahasim me te gjitha vendet e Ballkanit Perendimor. Nga vendet e rajonit, Serbia ka regjistruar vlerën më të lartë të kredive joperformuese me 22.8 %, përderisa Shqipëria ka regjistruar 20.9 % nga bruto totali i kredive në fund të vitit 2015. Pas këtyre dy shteteve, radhiten Kroacia me 17.1 % (e cila tashem eshte pjese e Unionit European me te drejta te plota), Mali i Zi me 16.7 % dhe kështu me radhë. Nga të gjitha shtetet e paraqitura, Kosova është i vetmi vend në rajon i cili ka arritur të mbaj përqindjen e kredive joperformuese në nivel njëshifror, madje këtë përqindje në fund të vitit 2015 ka arritur që ta zvogëloj edhe më shumë nëse krahasohet me dy vitet paraprake.

Nga vendet e rajonit, Serbia ka regjistruar vlerën më të lartë të kredive jo-performuese me 22.8%, përderisa Shqipëria ka regjistruar 20.9% nga bruto totali i kredive në fund të vitit 2015. Pas këtyre dy shteteve, radhiten Kroacia me 17.1%, Mali i Zi me 16.7% dhe kështu me radhë. Nga të gjitha shtetet e paraqitura, Kosova është i vetmi vend në rajon i cili ka arritur të mbaj përqindjen e kredive jo-performuese në numra njëshifror, madje këtë përqindje në fund të vitit 2015 ka arritur që ta zvogëloj edhe më shumë nëse krahasohet me dy vitet paraprake.

Kreditë jo-performuese në raport me gjithsej kreditë në vendet e Ballkanit perendimor sipas viteve, i paraqesim edhe figurativisht, ne vijim:

Figura nr. 2 Kreditë jo-performuese në raport me gjithsej kreditë në vendet e Ballkanit perendimor sipas viteve



Burimi: *The Global economy.com The IMF,*

Në figurën e mësipërme, janë të paraqitura trendet e lëvizjeve të përqindjeve të kredive jo-performuese të vendeve me të cilat kufizohet Kosova.

Sipas publikimit të Shoqatës Bankare të Kosovës, trendi i kredive joperformuese të industrisë bankare në Kosovë është dukshëm më i vogël se sa i vendeve me të cilat kufizohet Kosova,¹² dhe është i vetmi vend që në mënyrë permanente, tregon se kreditë joperformuese, janë në nivel njëshifror.

¹² Niveli i kredive joperformuese, Dr. Sc. Petrit Balija, Shkurt 2016, fq. 3 - 4


2.3.3 Provizionimi i kredive joperformuese në Kosovë

E cekem edhe me pare se per cdo njesi monetare te plasuar ne treg financiar, bankat synojne qe te sigurohen se ato mjete do t'u kthehen te rritura per kamate-interes. Mirepo, ne menyre qe plasimi i mjeteve te mos paraqitet problem per afarizmin e bankave komerciale ato per cdo kredi te lejuar nfdajen mjete te caktuara, te cilat ne rast te mos kthimit te kredise te mund te mbulojne ato mjete. Kjo ne terminologjine profesionale njohet si provizionimi i kredive.

Figura në vijim tregon përqindjen e kredive jo-performuese dhe përqindjen e rritjes / zvogëlimit të kredive joperformuese në raport me përqindjen e rritjes së gjithsej portofolios kreditore.

Ne tabelen ne vijim, prezantojme raportin mes kredive joperformuese dhe gjithsej portofolios kreditore, por edhe provizionimin e kredive joperforuese ne Kosove, nder vite :

Figura nr. 3 Raporti mes kredive joperformuese dhe gjithsej portofolios kreditore, nder vite:



Burimi: Raportet vjetore te BQK-se, nder vite.

Në fund të vitit 2015 përqindja e kredive joperformuese shënoj vlerat prej 6.2 %, çka paraqet një zvogëlim të kësaj përqindje prej 18.9 % në raport me vitin 2014. Këtë zvogëlim e bën edhe më të rëndësishëm, përqindja e rritjes së portofolios kreditore prej 7.3 %, që nënkupton se pavarësisht rritjes së portofolios kreditore, përqindja e kredive joperformuese është zvogëluar.

Nga viti 2012 dhe deri më 2015 përqindja e kredive joperformuese ka shënuar ulje, siç mund të shihet edhe nga trendi i paraqitur në tabelën në lart.

Kapitulli IV

4. Konkluzionet dhe rekomandimet

4.1 Konkluzionet

Punimi trajton dy kategori ekonomike shumë më rëndesi për ekonominë kosovare në përgjithësi: inflacionin dhe kredite joperformuese si dy kategori që kanë efekt tejet të madh në zhvillim ekonomik.

Ekonomia e Kosovës, perkundër faktit që filloi nga zeroja, pasi që lufta shkatroi gati cdo gjë, kishte një rritje të knaqshme ndër vite. Mirëpo, një e rritje e tillë është me tepër si rezultat i një baze tejet të ultë, andaj rezultoi me një përqindje relativisht të knaqshme, se sa që është një rritje e mirëfilltë. Siq vërehet nga analiza e të dhënave makroekonomike në vend, rritja ekonomike tek ne ka shënuar rritje permanente, ndër vite, që mesatarisht në decenien e fundit sillet rreth 4 përqind në baza vjetore, mirëpo duke pasur parasysh nivelin e zhvillimit ekonomik në të cilin aktualisht është Kosova, një rritje e tillë nuk është e mjaftueshme.

Ndërsa, sa i përket inflacionit, gjendja është përkeqësuar posaqerisht në dy vitet e fundit, si pasojë e Covid - 19 dhe posaqerisht luftës në Ukrainë, që shkaktoi shkeputjen e zingjirit të furnizimit në mbare botën dhe rezultoi me pa-voja në tejet negative edhe tek ne. Aq më tepër ekonomia e Kosovës është ekonomia e importit, andaj problemet rreth importit të mallrave, por edhe paniku bëri që artikujt baze të shtrenjtohen shumë dhe rezultuan me norme dyshifrore inflatore me 2022.

Lidhur me kredite joperformuese, mund të konstatohet që kredite të tilla mund të sjellin probleme të mëdha jo vetëm për bankën konkrete, por edhe për tërë sistemin bankar dhe tërë ekonominë. Andaj trajtimi i tyre me kujdes është i ne-rëndesie vitale për tërë sistemin bankar dhe ekonomik. Kredite joperformuese, për-kundër faktit që krahasuar me vendet e Ballkanit

Perendimor, jane me te ultat nder vite, gjithnje jane ne monitorim jo vetem nga bankat komerciale, por edhe nga autoriteti rregullativ.

4.2 Rekomandimet

Në bazë të shqyrtimit të deritanishëm si dhe analizës së literaturës adekuate dhe të dhënave statistikore makroekonomike, mund të nxjerrim disa konkluzione për një grup të gjërë akterësh.

Rekomandimet për *politikëbërësit*:

-Qeveria përmes politikave fiskale dhe monetare duhet të nxisë zhvillimin dhe lehtësimin e të bërit biznes, në mënyrë që bizneset të kenë një zhvillim më të shpejt, gjë që do t'i kthejë përmes pagesës së taksave më të mëdha, andaj edhe të hyra më të mëdha buxhetore.

-të ndërmerren masa për stimulim të prodhimit dhe të bujqësisë (posaqërisht në sferën e përpunimit të produkteve bujqësore). Pra të nxitet agrobiznesi e jo si deri tani ku më tepër është stimuluar agrokultura, siq ka ndodhur deri tani, përmes granteveve bujqësore.

Masat e ndërmarra deri tani në luftimin e inflacionit (posaqërisht masat e politikës fiskale tejet të vonuara) nuk janë kompatible me situatën inflatore në vend.

Rekomandimet për *autoritetin rregullativ*:

-Banka Qendrore, duhet t'i mbaj në kujdes të shtuar bankat komerciale, jo vetëm rreth provizionimit të kredive të lejuara, të cilat janë në vonesë, por duhet të jetë më strikte në politiken e monitorimit posaqërisht në fushën e ekzaminimit paraprak dhe vlerimit të aftësisë kreditore të klientve.

-Banka Qendrore t'i obligon bankat komerciale që të kenë trajnime më specifike rreth vlerimit të kapacitetit të klientve.

-Banka Qendrore, të vazhdojë me mbikqyrje permanente të bankave komerciale gjithnjë, jo vetëm sipas itinerareve të paracaktuara.

Literatura

2. Agjensioni Statistikor i Kosovës(ASK)/raportet vjetore, 2010-2021
3. Banka Boterore-World Bank: Raportet sipas viteve konkrete (2010-2015)
4. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës: Raporti vjetor , 2010-2021, Prishtine,
5. Komoni, Sabahudin: Finance, Prishtine, 2011
6. Luboteni, G: Banka dhe afarizmi bankar, Prishtine, 2009
7. Spahiu-Gjikolli, F. Normat e interesit dhe kapitali bankar– një analizë paneli për disa vende të Ballkanit” 2017, Tirane, punim doktrate ne doreshkrim,
8. SHBK: Niveli i kredive joperformuese, 2016,
9. SHBK; Raportet periodike sipas viteve, 2010-2021
10. Tmava, Qazim: Financa, Ligjerata te autorizuar, 2021
11. The Global economy.com The IMF, 2010-2021

Web faqe:

<https://www.mei-ks.net/sq/kosova/ekonomia-e-kosoves#sthash.yjfS2Jo1.dpuf>

BQK, Raporti Vjetor www.bqk-kos.org

SHBK, www.bankassoc-kos.com

www.bqk-kos.org